

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë **Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.




Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda **30 ditëve**, nga:

- a. data kur ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
  - b. data e kalimit të afatit të parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
- Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell **përgjegjësi administrative**, sipas rasteve të parashikuara **në nenin 18 të ligjit nr.119/2014**.

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta anki-mojë vendimin e Komisionerit në gjykatën admin-istrative kompetente.

**Ligji ka për qëllim** - garantimin e njohjes së publi-kut me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit.

**Ligji ka për qëllim** - nxitjen e integritetit, të trans-parencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.



**Çdo person gëzon të drejtën e njo-hjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet**

**Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**



Rr. Kavajës, Nd. 80, H. 1, Kati 5  
1023, Tiranë, Shqipëri  
Tel. : +355 422 237 200  
info@kmdp.al / eëë.kmdp.al

